

Udhëzime për përdorimin e të dhënave në rastin e përdorimit të teknologjisë Car2X

A. Udhëzime të përgjithshme

Me këtë politikë për privatësinë dëshirojmë t'ju informojmë për përdorimin e të dhënave tuaja në rastin e përdorimit të teknologjisë Car2X, sapo automjeti juaj të jetë i pajisur me teknologjinë Car2X dhe teknologjia Car2X të jetë aktive. Udhëzimet për përpunimin e të dhënave në automjetin tuaj përveç përdorimit të Car2X gjeni edhe në politikën për privatësinë për përdorimin e shërbimeve online me celular (We Connect, VW Connect). Versionin aktual të politikave të privatësisë mund ta gjeni në çdo kohë në <https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/carnet/al/sq/dataprivacy/latest/html> (We Connect, VW Connect) dhe <https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/carnet/al/sq/dataprivacycar2x/latest/html> (Car2X).

Përgjegjës për përpunimin e të dhënave në lidhje me teknologjinë Car2X të instaluar në automjetin tuaj është

Volkswagen AG
Berliner Ring 2
38440 Wolfsburg

regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Braunschweig nën numrin HRB 100484 (***, „Volkswagen AG“***)

B. Komunikimi Car2X

I. Rregullat themelore

Automjeti juaj është i pajisur me një teknologji Car2X. Nëse aktivizoni këtë funksion, automjeti juaj është në gjendje të shkëmbejë informacione të rëndësishme për qarkullimin rrugor, p.sh. për aksidentet ose bllokimet e trafikut, me pjesëmarrës të tjerë të trafikut ose të infrastrukturës së trafikut, për aq kohë sa këto e mbështesin gjithashtu teknologjinë Car2X. Si rrjedhojë, pjesëmarrja juaj në qarkullimin rrugor bëhet edhe më e sigurt. Nëse regjistroheni për herë të parë si përdorues në automjet, atëherë verifikoni, nëse cilësimi Car2X përkon me kërkesat tuaja dhe nëse është e nevojshme çaktivizoni manualisht Car2X.

Komunikimi bëhet drejtpërdrejtë ndërmjet automjetit tuaj dhe pjesëmarrësve të tjerë të trafikut ose të infrastrukturës së trafikut, në një zonë të afërt nga rreth 200 m deri në 800 m. Kjo autonomi mund të luhatet në varësi të mjedisit, p.sh. në tunele ose në qytet.

II. Disponueshmëria dhe siguria teknike

Automjeti juaj, për ofrimin e teknologjisë Car2X përdor funksione të caktuara bazë të automjetit tuaj, që gjithashtu i përpunon të dhënat personale.

1. Disponueshmëria teknike

Për të garantuar dhe siguruar një komunikim të sigurt me automjetin tuaj që ju t'i përdorni të gjitha shërbimet e blera ose të rezervuara shtesë me automjetin tuaj, krahasohet numri i identifikimit të automjetit (VIN), adresa IP e automjetit tuaj dhe koha e ruajtur në automjetin tuaj

me bazën tonë të të dhënave. Për mbrojtjen e identitetit tuaj dhe të dhënave tuaja, kodi VIN pseudonimizohet për aq kohë sa është e mundur. Përpunimi i këtyre të dhënave bëhet mbi bazën e interesave tona legjitime, për t'ju ofruar juve shërbime dhe funksione dhe në të njëjtën kohë për të parandaluar përdorimin e shërbimeve dhe funksioneve tona nga persona të paautorizuar. Baza ligjore e përpunimit është neni 6, paragrafi 1, germa f) e Rregullores Bazë për Mbrojtjen e të Dhënave – („GDPR“).

2. Serveri i të dhënave

Të dhënat përpunohen në serverët e përpunuesit të mëposhtëm të porosisë sipas udhëzimeve tona:

Audi AG
Auto-Union-Straße 1
85057 Ingolstadt
Deutschland

Amazon Web Services, Inc. („AWS“)
410 Terry Av. North
Seattle WA 98109
United States

Në AWS të dhënat do të enkriptohen në bazë të marrëveshjeve me ne dhe do të përpunohen vetëm në serverët e të dhënave në Bashkimin Evropian. Meqë AWS e ka selinë e saj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë lidhur garanci të arsyeshme në përputhje me BE për përpunimin e të dhënave në vendet jo-evropiane me AWS, për të mbrojtur në mënyrë të mjaftueshme të dhënat tuaja personale.

3. Ofruesi i shërbimeve IT

Ne përdorim gjithashtu ofrues të shërbimeve të ndryshme IT. Këta na mbështesin në fushën e mirëmbajtjes dhe të shërbimeve të suportit teknik. Lidhur me qasjen që këta ofrues shërbimi kanë tek të dhënat tuaja personale, ata i përdorin ato vetëm me porosinë tonë dhe sipas udhëzimeve tona. Me këta, janë lidhur kontrata për përpunimin e porosive sipas nenit 28 të GDPR, kështu që të dhënat tuaja edhe në fushën e përpunuesit të porosisë i nënshtrohen nivelit tonë të lartë të mbrojtjes.

III. Funksionalitetet Car2X

Car2X mund t'ju mbështesë në situatat e mëposhtme:

1. Paralajmërimi nga pikat lokale të rrezikut

Funksioni Car2X verifikon zonën në afërsi të përshkruar më sipër përreth automjetit tuaj, për t'ju treguar pikat e rëndësishme lokale të rrezikut. Këtu merren dhe vlerësohen informacionet e udhëtimit të pjesëmarrësve të tjerë Car2X. Nëse një automjet që udhëton përpara bën një frenim të emergjencës dhe e dërgon këtë informacion nëpërmjet Car2X, atëherë automjeti juaj shfaq një mesazh paralajmërues. Kini parasysh: Automjeti juaj për shkak të mesazheve të tilla paralajmëruese nuk kryen ndërhyrje të udhëtimit të automatizuar, pra p.sh. nuk bëhet një frenim i emergjencës në mënyrë të pavarur.

2. Zgjerimi i rregullatorit automatik të distancës

Teknologjia Car2X mund të zgjerojë sistemin parashikues të sensorëve të automjetit tuaj (p.sh. sistemet e radarit dhe të kamerave) dhe të dallojë më herët situatat e trafikut, kështu që ju mund të reagoni më herët për këtë. Nëpërmjet informacioneve të sakta për një situatë trafiku rregullatori automatik i distancës në lidhje me sistemin e kontrollit të shpejtësisë mund të reagojë në mënyrë parashikuese për fundin e një bllokimi në trafik dhe të përshtatë në mënyrë automatike shpejtësinë. Për më tepër, përmirësohet p.sh. funksioni për mbështetjen në rastin e ndërrimit manual të korsisë.

3. Funksionalitete të tjera

Nëse është e nevojshme në të ardhmen zhvillohen funksione të tjera Car2X. Nëpërmjet përpunimit të të dhënave në lidhje me funksionet e reja Car2X ju informoheni më vete.

IV. Shkëmbimi i të dhënave

Nëse aktivizoni teknologjinë Car2X, atëherë kjo dërgon njëra pas tjetrës informacione të përgjithshme të trafikut te pjesëmarrësit e tjerë Car2X (p.sh. automjete të tjera, infrastruktura) dhe u mundëson atyre një vlerësim të situatës aktuale të trafikut. Për këtë qëllim, transferohen të dhënat e mëposhtme: Informacionet për dërguesin Car2X (ID e përkohshme, tipi), informacionet e automjetit (përmasat e automjetit), informacionet në lidhje me udhëtimin (përshpejtimi, pozicioni gjeografik, drejtimi i lëvizjes, shpejtësia), informacionet nga sistemi i sensorëve të automjetit (shpejtësia e devijimit, kalimi në kthesa, statusi i dritave, statusi i pedalit dhe këndi i timonit) dhe itinerari (pikat e rrugës, pra të dhënat e pozicionit në 200 m deri në 500 m e fundit të udhëtimit).

Përveç kësaj, teknologjia e aktivizuar Car2X në rast të ngjarjeve të caktuara i transferon të dhënat shtesë të pjesëmarrësit e tjerë Car2X. Për këto ngjarje llogaritet në veçanti ndalimi i një automjeti, avaritë, aksidentet, ndërhyrjet e një sistemi aktiv të sigurisë dhe fundet e bllokimit të trafikut. Transferimi bëhet vetëm në rastin e ngjarjes. Gjithashtu transferohen të dhënat e mëposhtme: Informacionet e ngjarjes (lloji i ngjarjes, momenti i ngjarjes dhe momenti i njoftimit, pozicioni gjeografik, zona e ngjarjes, drejtimi i lëvizjes) dhe itinerari (pikat e rrugës, pra të dhënat e pozicionit në 600 m deri në 1000 m e fundit të udhëtimit).

Të dhënat e dërguara te pjesëmarrësit e tjerë Car2X pseudonimizohen. Kjo do të thotë, që ju si dërgues i informacionit nuk do t'ju shfaqeni pjesëmarrësve të tjerë Car2X.

V. Certifikata

Për të parandaluar një keqpërdorim në komunikimin e Car2X, informacionet Car2X përpara dërgimit tuaj shënohen me një certifikatë të pseudonimizuar. Me anë të shënimeve sistemi marrës Car2X mund të verifikojë, nëse një njoftim Car2X është autentik, pra është dërguar nga një dërgues legjitim Car2X dhe nuk është i manipuluar. Për t'i caktuar edhe sistemit tuaj Car2X një certifikatë të qartë, përdoret kodi VIN i automjetit tuaj dhe transferohet në një server Car2X. Si rrjedhojë mundësohet, që të sigurohet certifikata e pseudonimizuar për komunikimin Car2X. Serveri Car2X funksionon me porosi të Volkswagen AG nga NEXUS Technology GmbH, Carl-Zeiss-Straße 2, 76275 Ettlingen. Për të përmirësuar më tej sigurinë e të dhënave tuaja, sistemit tuaj Car2X i shpërndahen certifikata të reja në intervale të rregullta.

Gjatë aksesit në serverin Car2X të dhënat e transferuara së bashku me certifikatën e pajisjeve të komandimit, kodin VIN dhe parametrat e inicialeve për gjenerimin e certifikatës ruhen për 5 vjet dhe më pas fshihen automatikisht.

VI. Statistika e përdoruesit/ Qëllimi i analizës për sigurinë e automjetit

Për vlerësimin statistikor të përhapjes së teknologjisë Car2X në Evropë, kodi VIN dhe data e regjistrimit të automjetit përzgjidhen në Backend për teknologjinë Car2X nga IT-Backend. Të dhënat ruhen në një server të brendshëm të VW për 5 vjet dhe më pas fshihen automatikisht.

Në kuadër të afateve të shërbimit do të lexohen informacione specifike për automjetin nga automjeti juaj dhe do të dokumentohet historiku i mirëmbajtjeve të sistemit Volkswagen. Për të përjashtuar rreziqe që lidhen me sigurinë, regjistrimi i automjetit do të analizohet në Backend. Në kuadër të kësaj analize mund të ndodhë që të nevojitet verifikimi i historikut të automjetit, për të shmangur kufizime të mundshme funksionale ose sulme në sistemin C2X. Për këtë analizë nevojitet përdorimi i VIN. Ruajtja e të dhënave jashtë historikut nuk fillon. Volkswagen AG ka interes të përpunojë të dhënat vetëm në rast gabimesh / defektesh.

Në rastin e një defekti ose sulmi të identifikuar në sistemin C2X, kodi VIN nga i cili ndodh një sulm i mundshëm, përjashtohet nga pjesëmarrja në shërbimin C2X. Në këtë rast, për kodin VIN nuk ofrohen më certifikata dhe kodi VIN bllokohet në Backend.

Kodi VIN i bllokuar, nga i cili ndodh sulmi, ruhet në një server të brendshëm të VW për 5 vjet dhe shënohet si VIN i bllokuar. Riaktivizimi ndodh përmes Volkswagen AG me kërkesë të qartë të klientit dhe garantim të përdorimit të rregullt të teknologjisë C2X.

C. Qëllimet e përpunimit, baza ligjore dhe të drejtat e personave në fjalë

Përpunimi i të dhënave tuaja bëhet për sigurimin e teknologjisë Car2X si dhe për mbështetjen e sigurisë së qarkullimit rrugor në interesin tuaj dhe interesin e pjesëmarrësve të tjerë të trafikut. Kërkimi i kodit VIN si dhe i datës së regjistrimit të parë të automjetit në Backend për teknologjinë Car2X bëhet për vlerësime statistikore. Me anë të të dhënave të mbledhura sigurohet që regjistrimi të funksionojë pa probleme në tërësi dhe të mos paraqitet asnjë rast defekti sistematik global.

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave është mbrojtja e interesave legjitime (neni 6, paragrafi 1, germa f) e GDPR).

Në rastin e ofrimit të Car2X për mbrojtjen e cilësimeve të privatësisë suaj të dhënat përpunohen vetëm për shtrirjen mundësisht sa më të pakët dhe më pas transferohen te Volkswagen AG për dhënien e certifikatës për sistemin tuaj Car2X.

Lidhur me të dhënat tuaja të përpunuara nga Volkswagen AG, në rastin e përmbushjes së kushteve paraprake ligjore, juve ju takojnë të drejtat e mëposhtme, të cilat mund t'i zbatoni në çdo kohë pa pagesë kundrejt Volkswagen AG. Më shumë informacione për ushtrimin e të drejtave tuaja i gjeni në faqen e internetit <https://www.datenschutz.volkswagen.de>.

I. E drejta për informim

Ju keni të drejtë të merrni prej nesh informacione lidhur me trajtimin e të dhënave tuaja personale.

II. E drejta e korrigjimit

Ju keni të drejtën të kërkonit nga ne korrigjimin e të dhënave tuaja personale nëse janë të pasakta ose të paplota.

III. E drejta për fshirje

Ju keni të drejtën të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja, nëse përmbushen kushtet paraprake të përmendura në nenin 17 të Rregullores Bazë për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR). Sipas këtij neni, ju keni të drejtë, për shembull, të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja, për sa kohë që ato nuk janë më të nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur. Përveç kësaj, mund të kërkonti fshirjen, nëse të dhënat tuaja i përpunojmë në bazë të miratimit tuaj dhe ju e revokoni këtë miratim.

IV. E drejta për kufizimin e përpunimit

Ju keni të drejtë të kërkonti kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja, nëse përmbushen kushtet paraprake të nenit 18 të GDPR. Kjo mund të ndodhë, për shembull, nëse kontestoni saktësinë e të dhënave tuaja. Për kohëzgjatjen e verifikimit të saktësisë së të dhënave, mund të kërkonti kufizimin e përpunimit.

V. E drejta për kundërshtim

Nëse përpunimi i të dhënave bazohet në një interes legjitim mbizotërues të Volkswagen AG ose të një pale të tretë (neni 6, paragrafi 1, germa f) e GDPR), ju keni të drejtën të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja. Ju mund ta kundërshtoni përpunimin edhe në rastet, në të cilat është i nevojshëm përpunimi për zbatimin e një detyre, që ose është në interesin publik ose bëhet në ushtrimin e autoritetit zyrtar (neni 6, paragrafi 1, germa e) e GDPR). Edhe në lidhje me përpunimin e të dhënave për qëllime të reklamimit të drejtpërdrejtë juve ju takon e drejta për kundërshtim. Kjo vlen edhe në lidhje me profilizimin dhe në fakt, si për rastin që ky kryhet në bazën e një interesi legjitim mbizotërues (neni 6, paragrafi 1, germa f) e GDPR), ashtu edhe për rastin që ky lidhet me reklamimin e drejtpërdrejtë. Në rast refuzimi, ju lutemi të na thoni arsyet e këtij refuzimi për përpunimin e të dhënave. Përpunimin e të dhënave për qëllimet e reklamimit të drejtpërdrejtë mund ta kundërshtoni pa dhënë ndonjë arsye. Gjithashtu, mund të kundërshtoni përpunimin e të dhënave për qëllimet e profilizimit pa dhënë ndonjë arsye, nëse ky lidhet me reklamimin e drejtpërdrejtë.

VI. E drejta për transmetimin e të dhënave

Për sa kohë që përpunimi i të dhënave bazohet në miratimin ose në zbatimin e një kontrate dhe kryhet edhe përmes një përpunimi të automatizuar, keni të drejtën t'i merrni të dhënat tuaja në një format të strukturuar, të përdorur gjerësisht dhe të lexueshëm nga kompjuteri, si dhe t'i transferoni ato te një përpunues tjetër të dhënash.

VII. E drejta e revokimit

Për sa kohë që përpunimi i të dhënave bazohet në një miratim, keni të drejtën që ta revokoni në çdo kohë dhe pa pagesë përpunimin e të dhënave në kuadrin e një miratimi me efekt në të ardhmen.

VIII. E drejta e ankimit

Ju keni gjithashtu të drejtë të paraqisni një ankesë pranë autoriteteve mbikëqyrëse (p.sh. pranë Zyrtarit të shtetit për përpunimin e të dhënave në Niedersachsen) lidhur me përpunimin që ne u bëjmë të dhënave tuaja.

IX. Kufizimet

Njoftimet Car2X të shkëmbyera ndërmjet automjetit tuaj dhe pjesëmarrësve të tjerë të trafikut ose infrastrukturës së trafikut nuk transferohen te Volkswagen AG ose të ruhen nga ky. Kini parasysh që për këtë arsye ne nuk mund t'ju ofrojmë asnjë të drejtë për informacion, korigjim, fshirje ose

transmetueshmëri të të dhënave kryesisht për të dhënat tuaja Car2X. Nëse nuk dëshironi asnjë përpunim tjetër të të dhënave tuaja, mund ta çaktivizoni në çdo kohë teknologjinë Car2X të automjetit tuaj. Një përpunim i të dhënave tuaja, duke u nisur nga përditësimi i certifikatës (B.V.), nuk ndodh më. Përpunimet e të dhënave për disponueshmërinë teknike (B. II. 1.) dhe përditësimin e certifikatës (B.V.), edhe në rastin e teknologjisë Car2X, janë të nevojshme për të siguruar në çdo kohë disponueshmërinë e këtij funksioni, sapo ta aktivizoni (përsëri) atë. Një përditësim i certifikatës dhe përpunimet e të dhënave për disponueshmërinë teknike nuk ndodh, nëse e kaloni automjetin tuaj në cilësimet e privatësisë në modalitetin Offline.

D. Partneri juaj i kontaktit

Pika e kontaktit për ushtrimin e të drejtave tuaja dhe informacione të mëtejshme për mbrojtjen e të dhënave i gjeni në faqen e mëposhtme të internetit <https://www.datenschutz.volkswagen.de>.

Oficeri për mbrojtjen e të dhënave të Volkswagen AG është në dispozicionin tuaj si partner i kontaktit për çështje të lidhura me mbrojtjen e të dhënave:

Përgjegjësi për mbrojtjen e të dhënave i Volkswagen AG
Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg
dataprivacy@volkswagen.de

Versioni i informacioneve të shfaqura:
Politika e privatësisë [mars 2023]

Versionin aktual të politikës së privatësisë mund ta gjeni në çdo kohë në <https://consent.vwgroup.io/consent/v1/texts/carnet/al/sq/dataprivacycar2x/latest/html>.